

Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës

Ka kënaqësinë që të ftojë të gjithë të interesuarit për të depozituar punimet e tyre në:

KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE TË KONKURRENCËS

**4 Mars 2014
Tirane**

Tema e Konferencës: “Konkurrenca dhe Rritja Ekonomike”

Konkurrenca është një faktor i rëndësishëm në ekonominë e një vendi, është tregues i mirëfunksionimit të tregut, është faktori që detyron prodhuesit të ulin çmimet ose të përmirësojnë produktet e tyre për tërheqjen konsumatore, është faktori që ndikon në shumëllojshmërinë e produkteve, mbrojnë konsumatorët dhe përdoruesit nga praktikant anti konkurrenciale që çojnë në rritjen e çmimeve, promovon transparencën dhe çon në tërheqjen e investimeve të huaja, etj.

Qëllimi kryesor i Konferencës është nxitja e debatit ndërmjet ekspertëve, akademikëve, përfaqësuesve të autoriteteve homologe të konkurrencës, përfaqësuesve të qeverisjes qendrore dhe enteve rregullatorë, përfaqësuesve të sistemit të gjyqësorit, përfaqësuesve të biznesit, grupeve të interesit, etj., për të bërë të mundur këndvështrimin dhe gjetjet e tyre në lidhje me çështjet e konkurrencës në Shqipëri.

Të gjithë pjesëmarrësit e interesuar mund të paraqesin një abstrakt me jo më shumë se 250 fjalë, i cili duhet të depozitohet deri në 5 Shkurt 2014. Abstraktet do të shqyrtohen dhe pranohen mbi bazën e cilësisë së tyre dhe lidhjes me fushën e studimit të Konferencës. Të gjithë autorët e përzgjedhur për të marrë pjesë, do të njoftohen nëpërmjet një e-maili për të dërguar punimin e tyre të plotë. Punimi i paraqitur duhet të jetë në përputhje me linjat e propozuara në abstrakt. Të gjitha punimet e përzgjedhura për pjesëmarrje duhet të jenë origjinale dhe të mos jenë publikuar tjetërkund.

Konferenca do të jetë e përqendruar, por jo e kufizuar në temat e mëposhtme:

1. Konkurrenca në tregjet e rregulluara (Konkurrenca v.s rregullatorit në fushën e telekomunikacioneve; energjisë; prokurimeve publike etj; konkurrenca v.s. stabilitetit financiar (sistemi bankar, sigurimet etj)
2. Zbatimi i modelit SCP (Struktura e Tregut, Sjellja dhe Performanca);
3. Roli i konkurrencës (Marrëveshjet e ndaluara/Abuzimi me pozitën dominuese) në krizat ekonomike; (Konkurrenca në kohë krize);
4. Advokacia e Konkurrencës, Kultura e Konkurrencës dhe Politika e Konkurrencës; etj.

Pjesëmarrës kryesorë në Konferencë: William E. Kovacic: Profesor i së Drejtës së Konkurrencës dhe Politikës së Konkurrencës; Qendra për Ligjin mbi Konkurrencën.

William E. Kovacic aktualisht është Profesor i së Drejtës së Konkurrencës dhe Politikës së Konkurrencës në Universitetin George Washington , ku është edhe Drejtor i Qendrës së Ligjit mbi Konkurrencën. Më parë ka qenë Komisioner i Federal Trade Commissioner

DATA TË RËNDËSISHME

Dorëzimi i abstrakteve	5 Shkurt, 2014
Njoftimi i pranimit	10 Shkurt 2014
Dorëzimi i draft punimeve	25 Shkurt 2014
Data e Konferencës (Prezantimi në power point)	4 Mars 2014

Propozimi me 250 fjalë duhet të dërgohet në: Competition@caa.gov.al dhe Daniela.Mehmeti@caa.gov.al

Udhëzime për abstraktin:

Abstraktet e dorëzuara duhet të shkruhen në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

- Gjuha zyrtare e Konferencës : Anglisht dhe Shqip.
- Abstrakti duhet të tregojë qartësisht qëllimin e kërkimit dhe lidhjen e tij me temën e Konferencës;
- Emrin e Autorit: emrin e plotë të autorit/autorëve, përkatësinë institucionale, dhe adresën e e-mail-it.
- Abstraktet duhet të paraqiten në formatin Microsoft Word dhe duhet të shkruhen në shqip ose anglisht.

Udhëzimet për shkrimin e punimit:

- Punimi duhet të shkruhet në një dosje Word dhe nuk duhet të jetë më i gjatë se 10 faqe, përfshirë grafiket, tabelat dhe referencat.
- Punimet mund të shkruhen në anglisht ose në shqip.
- Formati i shkrimit: 12-pt. Font Times New Roman dhe 10-pt. për referencat.
- Hapësira ndërmjet rreshtave: Hapësirë teke;

Pjesëmarrja në këtë konferencë është **pa pagesë**.

Për çdo pyetje lidhur me konferencën, ju lutem të mos hezitoni të kontaktoni:

Albanian Competition Authority

E-mail: competition@caa.gov.al dhe/ose Daniela.Mehmeti@caa.gov.al

Tel +355 4 2 234 504

fax: +355 4 2 234 497